

# EU POLICY BRIEFS MACEDONIA



## **Politika energjetike e Republikës së Maqedonisë: Gazifikimi dhe kuadri ligjor – pasqyra**

Qershor 2014

[www.kas.de/macedonia](http://www.kas.de/macedonia)

[www.macef.org.mk](http://www.macef.org.mk)

Gazifikimi është temë aktuale me përmasa botërore, i cili gjithsesi se e tangon edhe Republikën e Maqedonisë, veçanërisht kohëve të fundit, kur ndjehet një "lëvizje" në këtë fushë. Punimi, në pjesën e parë e pasqyron gjendjen në Republikën e Maqedonisë lidhur me tregun e gazit natyror, si dhe nevojat dhe furnizimin me energji, ndërsa në pjesën e dytë është pasqyruar kuadri ligjor lidhur me aktet normative të BE-së.

**KONSTANTIN DIMITROV DHE  
ZOJA TAREVSKA**

MACEF, Republika e Maqedonisë



## Parathënie

Problematika lidhur me zhvillimin e gazifikimit është temë kryesore jo vetëm në Republikën e Maqedonisë ose Evropë por edhe në përmasa botërore. Ndikimi ekonomik i këtij burimi energjetik dhe roli gjeostrategjik politik janë shumë të fuqishëm.

Janë bërë përpjekje që në një vend të prezantohen gjendjet në Republikën e Maqedonisë në këtë fushë, nevoja për energji dhe pritshmëritë e furnizimit me sasi të mjaftueshme të energjisë cilësore.

Një rol të rëndësishëm gjatë realizimit të detyrave teknike kanë aktet normative ligjore dhe nënligjore, me një pasqyrë të veçantë të kuadrit ligjor nacional dhe direktivave të BE-së nga ky sektor.

Materiali është hartuar në dy pjesë. Pjesa e parë, ajo teknike, me një vështrim ndaj gjendjes energjetike është hartuar nga Prof. Dr. Konstantin Dimitrov, inxhinier i diplomuar i makinerisë.

Pjesa e dytë, e cila jep pasqyrën e kuadrit ligjor dhe akteve normative të BE-së në sektorin me gaz natyror, u hartua nga znj. Zoja Tarevska, politikologe e diplomuar, kah fundi i studimeve të saj pasuniversitare.

## Pjesa I – ENERGJETIKA DHE GAZI NATYROR

### 1. Hyrje

Në Republikën e Maqedonisë, pas stagnimit prej një dekade, sa i përket zhvillimit të përdorimit të gazit natyror, është evidente lëvizja në këtë sektor. Dhe sigurisht, një gjë e këtillë është për t'u përshëndetur, me një dozë keqardhjeje për atë se dinamika aktuale duhej të ndodhte më herët.

Duhet të shihet se cili ishte shkaku për një ngecje të këtillë në zhvillimin e përdorimit të gazit natyror (ndikime të brendshme ose të jashtme, apo kombinimi i të dyjave) dhe çka duhet të ndërmerret për realizimin më të shpejtë të kësaj detyre. Në mënyrë të qartë e përkufizojmë detyrën dhe jo idenë.

Që ta kuptojmë se çka ndodh dhe çka mund të bëjë shoqëria, fillimisht duhet të bëhet një analizë mbi gjendjen me konsumin e energjisë në të gjitha sektorët e shtetit dhe të përcaktohen burimet e furnizimit me këtë energji. Çdoherë është më mirë të shfrytëzohen resurset vetjake, sesa të importohet energji.

Nëse nuk posedohen resurse vetjake, duhet të përzgjidhet se cila formë e energjisë duhet të importohet – primare ose e transformuar. Kur do të përcaktohet se importi i energjisë primare sjell më shumë përfitime, në krahasim me importin e energjisë së transformuar, edhe

më tej mbetet dilema se cilit burim energjetik duhet t'i jepet përparësi? Ose të importohen më shumë lloje të bartësve të energjisë (energensa) për shkak të diversifikimit dhe ballafaqimit më të lehtë me mungesën periodike (nga cilido qoftë shkak) të ndonjë lloji të burimit energjetik (naftë, gaz natyror ose formë të transformuar të energjisë elektrike).

Dhe, nëse përcaktohet burimi energjetik, mbetet çështje e hapur prej ku të blihet, prej ku të transportohet, të blihet në bazë të marrëveshjeve afatshkurtra (bursë) ose në bazë të marrëveshjeve afatgjata për furnizim me një formë të caktuar të energjisë – ndërkaq në këtë rast me gaz natyror.

Përgjigjja në këto pyetje nuk është e lehtë dhe varet nga shumë faktorë, ndërsa në disa raste ato edhe nuk janë të natyrës së pastër energjetike ose ekonomike, por kanë të bëjnë me politika afatgjate dhe vendime strategjike. Për më tepër, ato ndryshohen varësisht nga gjendja në një periudhë të caktuar kohore kështu që një vendim i miratuar në këtë moment, i cili i përmbush kriteret energjetike dhe ekonomike, kur do të perceptohet nga një distancë kohore prej 10 ose 20 vitesh, mund të shënohet si një dështim i madh.

Nevoja (uria) për energji, e ndjek zhvillimin e shoqërisë, rritjen e standardit jetësor, nevojat e zhvillimit teknologjik. Kur rritet nevoja për energji, në përputhje me kushtet e tregut, është e natyrshme të pritet (që është edhe realitet) të rritet çmimi i energjisë. Çdo individ, familje ose shtet është e natyrshme të përpiqen t'i reduktojnë këto efekte negative mbi buxhetin e tyre dhe për këtë shkak paraprkishtë i planifikojnë shpenzimet dhe masat se si të ballafaqohen me nevojën e rritur për energji dhe me çmimin gjithnjë e më të lartë të saj.

Për këto shkaqe në Republikën e Maqedonisë ndërmerren masa strategjike për ballafaqimin me gjendjet e këtilla. Është hartuar Strategjia për Zhvillim të Qëndrueshëm, në të cilën njëra nga shtyllat kryesore është energjetika. Për këtë qëllim u miratuan tre dokumente strategjike edhe atë: Strategjia për Zhvillimin e Energjetikës në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2030<sup>1</sup>, Strategjia për Avancimin e Efikasitetit Energjetik deri në vitin 2020<sup>2</sup>, si dhe Strategjia për Shfrytëzimin e Burimeve të Rinovueshme Energjetike në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2020<sup>3</sup>.

<sup>1</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 61/2010

<sup>2</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 143/2010

<sup>3</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 125/2010



Këto dokumente janë shtyllat kryesore të politikave energjetike të Republikës së Maqedonisë, të përkufizuara si detyrim edhe me Ligjin për energjetikë. Realizimi i këtyre dokumenteve strategjike është parashikuar me përpilimin e planeve të veprimit.

Në Sektorin për Efikasitet Energjetik është përpiluar Plan Veprimi i Parë Nacional për Efikasitet Energjetik (PVNEE) për periudhën kohore 2010-2018, ndërkaq tanimë është përpiluar në formë përfundimtare edhe Plan Veprimi i dytë për Efikasitet Energjetik – PVEE (pret të miratohet këtu tek ne, ndërkaq kaloi në Sekretariatit e Komunitetit Energjetik). U miratua edhe Urdhëresë për arritjen e qëllimit për 9% konsum të reduktuar të energjisë deri në vitin 2018, në krahasim me periudhën referente 5 vjeçare. Është përpiluar edhe Programi për Realizimin e Strategjisë për Zhvillimin e Energjetikës në Republikën e Maqedonisë për periudhën kohore 2012 – 2016, si dhe Plan Veprimi për Burime të Rinovueshme të Energjisë për Republikën e Maqedonisë.

Këto dokumente janë harmonizuar me politikat e BE-së, kështu që, Republika e Maqedonisë i mbështetë objektivat e BE-së për vitin 2020, sa i përket reduktimit të konsumit të energjisë primare për 20%, reduktimit të emisionit të ndotësve për 20% dhe rritjes së pjesëmarrjes së energjisë që prodhohet nga burime të rinovueshme të energjisë për 20% në bruto konsumin e energjisë finale.

Komuniteti Energjetik i BE-së dhe palët kontraktuese, përfshirë edhe Republikën e Maqedonisë, u angazhuan për përmirësimin e gjendjes së mjedisit jetësor edhe atë nga aspekti i gazit natyror dhe energjisë elektrike, efikasitetit energjetik dhe burimeve të rinovueshme të energjisë, duke e marrë parasysh se për t'i arritur këto qëllime, duhet të inkorporohet një strukturë rregullatore gjithëpërfshirëse dhe e integruar në treg, e mbështetur nga institucione të fuqishme dhe me një monitorim efektiv, si dhe me përfshirjen përkatëse të sektorit privat.

## **2. Gjendja aktuale me sistemin e gazifikimit në Republikën e Maqedonisë**

Republika e Maqedonisë nuk ka vendburime të veta të gazit natyror. Gazi natyror importohet nga Rusia përmes Korridorit Ndërkombëtar 8, i cili kalon nëpër Ukrainë, Moldavi, Rumani dhe Bullgari. Gazsjellësi magjstral në Republikën e Maqedonisë hyn në Deve Bair në kufirin me Bullgarinë dhe shtrihet nëpër Kriva Pallankë, Kratovë dhe Kumanovë deri në Shkup me një gjatësi prej 98 km. Gazsjellësi magjstral nën presion maksimal të punës ka

kapacitet prej 800 milionë Nm<sup>3</sup> në nivel vjetor me mundësi për rritje deri në 1200 milionë Nm<sup>3</sup> në nivel vjetor me ndërtimin shtesë të stacionit për kompresimin e gazit në fillim të gazsjellësit magjstral. Mirëpo, kjo mundësi potenciale tanimë është e dyshimtë, për shkak të vjetërsisë së tubacionit dhe rrezikut që të rritet presioni i gazit gjatë transportit të tij. Sasia e livrimit maksimal të gazsjellësit magjstral është 145 mijë Nm<sup>3</sup>/h. Në Republikën e Maqedonisë akoma (nuk është) parashikuar mundësia e magazinimit të gazit natyror.

Në gazsjellësin magjstral aktualisht janë realizuar 6 bllok stacione: Kriva Pallankë, Ginovcë, Kratovë, Veles, Kumanovë dhe Shkup-Jug. Përveç kësaj, janë realizuar edhe pika lidhëse për gazsjellës shpërndarës në perspektivë: lidhje në drejtim të Velesit, Serbisë Jugore, Romanocit dhe Tetovës.

Janë ndërtuar edhe pesë stacione kryesore për matje dhe rregullim, ndërsa gjashtë gazsjellësit ekzistues (të realizuar) shpërndarës kanë një gjatësi të përgjithshme prej 24,95 km, me ç'rast karakteristikat themelore të gazsjellësve shpërndarës të veçantë janë dhënë në tabelën, si vijon:

Gazsjellës shpërndarës në drejtim të	Kriva Pallankë	Ginovci	Kratovë	Kumanovë	Shkup-Jug	Shkup-Veri
Gjatësia (km)	1,521	1,692	4,592	6,972	8,314	1,859
Diametri (mm)	108	108	108	219	426	325

Në fazën e parë të gazifikimit të Republikës së Maqedonisë janë ndërtuar rrjete urbane të gazsjellësve në Shkup, Kumanovë, Kratovë dhe Kriva Pallankë. Të dhënat janë pasqyruar në tabelën, si vijon:

Diametër nominal (m)	Shkup gjatësia (m)	Kumanovë gjatësia (m)	Kratovë gjatësia (m)	Kriva Pallankë gjatësia (m)
DN 500	6.394			
DN 400	14.198			
DN 300	1.365			
DN 200	1.33	939		
DN 150	1.342	4.596	5.333	
DN 100	1.21	10	569	920
DN 50	30	30		
Gjithsej:	25.869	5.575	5.902	920

Në Strumicë është ndërtuar sistem për shpërndarjen e gazit natyror përmes furnizimit me automjete – autobota me gaz të kompresuar, duke realizuar të ashtuquajturin "rrjet virtual për furnizim me gaz natyror". Gazi natyror transportohet nga Bullgaria, me ndihmën e automjeteve të specializuara, deri në stacionin/rezervuarin e pranimit në Strumicë. Nga ky stacion, gazi natyror u shpërndahet

konsumatorëve përmes rrjetit nëntokësor deri te konsumatorët aktual dhe potencial.

Në periudhën e kaluar gazsjellësi magjstral shfrytëzohej në një shkallë prej rreth 10% nga kapaciteti i tij i projektuar. Në këtë fazë të zhvillimit të gazifikimit në Republikën e Maqedonisë, në Shkup në fakt nuk ekziston rrjeti i shpërndarjes. Konsumatorët, në të vërtetë drejtpërdrejtë janë lidhur me rrjetin e transmetimit.

Karakteristikë themelore e shfrytëzimit të deritanishëm të gazit natyror konsiston me atë se përdoret vetëm në industri dhe në objektet publike, e që është gjendje në të gjitha qytetet në të cilat ekziston rrjeti i gazit natyror.

Në rrjetin urban në Shkup janë lidhur më shumë se treqind konsumatorë industrial.

Këta konsumatorë gazin natyror e blejnë në kufirin e RM-së nga tregtarët ndërkombëtar me gaz natyror. Ata kanë lidhur kontrata për transmetimin e gazit natyror nga stacioni kryesor për matje dhe rregullim në Zhidillovë deri në stacionin e matjes dhe rregullimit në hyrje të objekteve ku e shpenzojnë gazin. Për këtë shërbim, këto firma operatorin e sistemit të transmetimit e paguajnë konform çmimit për transmetimin e gazit natyror të aprovuar nga KRRE.

Në Shkup, të gjitha ngrohtoret: ELEM Energjetikë, "Lindje", "11 Tetori" dhe "Shkup Veri" janë plotësisht të përshtatura për shfrytëzimin e të dy llojeve të karburantit (mazutit dhe gazit natyror), ndërsa nga ky vit edhe ngrohtorja "Perëndim", mund të shfrytëzojë gaz natyror, për shkak të ndërtimit të një pjese të unazës së parashikuar të gazit. Këtë mundësi potenciale tanimë e shfrytëzojnë edhe disa shkolla të cilat janë lidhur në rrjetin e gazit ose janë në fazë të lidhjes si dhe Qendra Klinike.

Janë ndërtuar edhe dy impiante energjetike me efikasitet të lartë për prodhimin e kombinuar të energjisë termike dhe elektrike të cilat e shfrytëzojnë gazin natyror si burim energjetik. Impianti i parë energjetik, KOGEL Veri, i ndërtuar me 10 motorë gazi, secili me fuqi prej 3MW, të cilët livojnë ngrohtësi të shfrytëzueshme prej 13 MW dhe energji termike për procese industriale 12 t/h. Impianti i dytë energjetik ka një kapacitet për prodhimin e energjisë elektrike në një sasi prej 236 MW dhe prodhimin e energjisë termike në sasi deri në 160 MW, e cila përdoret në sistemin e ngrohjes qendrore (sistem i ngrohjes qendrore).

Efikasiteti i sistemit për prodhim të kombinuar të energjisë elektrike është rreth 51.2%, në krahasim me

32% efikasitet të kapaciteteve që përdorin linjit në KEM Manastir.

Që të realizohet prodhimi i disperzuar i energjisë, me të gjitha përfitimet shoqëruese (financiare, ekologjike etj.) duhet të përshpejtohet ndërtimi i rrjetit transportues (magjstral) dhe rrjetit shpërndarës të gazit natyror deri te konsumatorët.

Është përpiluar studimi për sistemin e gazsjellësit<sup>4</sup> në të cilin janë analizuar korridoret transportuese për mundësimin e qasjes deri te gazi natyror të të gjitha rajoneve të Republikës së Maqedonisë. Nga konzorciumi i njëjtë janë përpiluar edhe projekte ideore me elaborate shoqëruese për 24 seksione të sistemit të gazsjellësit.

Është përgatitur dokumentacioni teknik: Projekte themelore për pesë seksione prioritare për rrjetet magjistrale të gazsjellësit, si vijojnë:

- Projekti themelor për seksionin KLEÇOVCE-NEGOTINË, LOT 1.
- Projekti themelor për seksionin KAVADAR-MANASTIR, LOT 2.
- Projekti themelor për seksionin NYJA SHTIP-HAMZALI, LOT 3.
- Projekti themelor për seksionin HAMZALI - STOJAKOV LOT 4.
- Projekti themelor për seksionin SHKUP-KËRÇOVË, LOT 5.




Foto 1. Seksione transportuese magjistrale

Me ngjyrë të zezë (Foto 1) është prezantuar seksioni i ndërtuar magjstral i gazsjellësit, me ngjyrë të kuqe seksionet prioritare prej të cilave një pjesë duhet të realizohet me mjetet (60 milionë dollarë) e borxhit kliring

<sup>4</sup> Studimi i Fizibilitetit për sistemin gazsjellës në Republikën e Maqedonisë, i përgatitur nga Konzorciumi: "Prostor" SHPK – Kumanovë, "Energo Sistem" SHPK Shkup, GASTEC Sofje, "Petrol" Lubjanë dhe EIHP Zagreb nga muaji qershor 2010



të Rusisë, ndërsa me ngjyrë të gjelbër janë prezantuar seksionet e tjera.

Është përpiluar edhe Studimi<sup>5</sup> për ndërtimin e rrjetit shpërndarës të gazit natyror në qytetet më të mëdha të Republikës së Maqedonisë.

### 3. Politika energjetike – a kemi nevojë për gaz natyror?

Republika e Maqedonisë, sikurse edhe shumë vende tjera të botës, synon t'i shmanget varësisë së madhe nga importi i energjisë. Edhe pse Republika e Maqedonisë posedon vendburime të linjtit dhe hidro-kapacitete, të cilët shërbejnë si burime primare për prodhimin e energjisë, situata aktuale do të ndryshojë me shterimin e resurseve ekzistuese të thëngjillit.

Konsumi i energjisë tek konsumatorët e fundit është kategorizuar në disa sektorë themelorë edhe atë industria si konsumator më i madh i energjisë, menjëherë pas saj janë amvisëritë-sektori rezident me një pjesëmarrje prej mbi 27%, pastaj pason transporti, sektori terciar, (objekte komerciale publike) dhe me një pjesëmarrje shumë të vogël bujqësia dhe përmbushja e nevojave jo energjetike. Një vëmendje e veçantë duhet t'i përkushtohet nevojës për energji në sektorin e ndërtesave, meqë shqyrtimi i përbashkët i sektorit rezident dhe terciar janë treguar si konsumatorë më të mëdhenj të energjisë me përafërsisht 40% nga nevojat e përgjithshme. Në formë grafike është pasqyruar pjesëmarrja e sektorëve në konsumin e energjisë, Foto 2.




Foto 2. Pjesëmarrja e sektorëve në konsumin final të energjisë në vitin 2012

Ky raport i konsumit të energjisë në sektorë të veçantë ndryshon nga viti në vit, mirëpo pa ndryshime të ndjeshme që është dhënë në mënyrë grafike në Foto 3.

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave, në vitin 2012 prodhimi i përgjithshëm primar i energjisë në Republikën e Maqedonisë ishte 1517.8ktoe ose 51.0% nga energjia e nevojshme e përgjithshme. Energjia e nevojshme e përgjithshme për vitin 2012 është 2973.5ktoe.

Energjia tjetër e nevojshme është nga importi edhe atë sasia e përgjithshme e hidro-karburanteve, e gazit natyror, një sasi e caktuar e thëngjillit të cilësisë së lartë dhe energjisë elektrike.




Foto 3. Ndryshimi i raporti të konsumit të energjisë finale sipas sektorëve

Nga Foto 4 mund të shihet se gazi natyror merr pjesë në përmbushjen e nevojave të energjisë me një shumë të pakonsiderueshme prej 2%.




Foto 4. Pjesëmarrja e burimeve energjetike në konsumin final të energjisë në vitin 2012

Kjo gjendje urgjentisht duhet të ndryshohet. **Republika e Maqedonisë nuk guxon të mbetet në nivelin ekzistues: varësi nga importi i hidro-karburanteve dhe energjisë elektrike.**

Meqë Republika e Maqedonisë është një ekonomi e vogël, doemos duhet të mbetet e hapur për mundësitë në kuadër të të cilave qytetarët e saj dhe resurset vendore

<sup>5</sup> Studimi i Fizibilitetit për zhvillimin e rrjeteve shpërndarëse të gazit natyror në Republikën e Maqedonisë, 2013/2014



do të mund të ofrojnë përfitime të mëdha konkurrencte dhe me afat të gjatë për vendin. Prandaj, edhe pse zbatimi i aktiviteteve për efikasitet energjetik me siguri do t'i zbus rreziqet dhe vulnerabilitetin, sa u përket rezervave energjetike, rritja e pavarësisë së përgjithshme energjetike është objektiv strategjik. Ekzistojnë modele të ndryshme për evaluimin e nivelit të diversifikacionit dhe shkallës së vulnerabilitetit të sistemit energjetik.

Ndërtimi i përshpejtuar i rrjetit shpërndarës të gazit natyror do t'i mundësojë industrisë të shkojë në drejtim të modernizimit të pajisjes dhe proceseve, gjë e cila do të mundësojë reduktimin e konsumit të energjisë për njësi prodhimi, do të reduktohet prodhimi i produkteve të dëmtuara (produkte me të meta)/ produkte me cilësi të ulët dhe do të arrihet cilësi më e lartë për një periudhë më të shkurtër kohore. Si vlerë e shtuar të këtij procesi është emisioni i reduktuar i ndotësve në mjedisin jetësor.

Qytetarëve duhet t'u ofrohet përzgjedhje e më shumë llojeve të burimeve energjetike, ndërsa konkurrenca sigurisht se do të kontribuojë që të shënojë rënie çmimi i tyre tek konsumatorët, si dhe të rritet cilësia e furnizimit.

#### **4. Pasqyrë e shkurtër e objektivave strategjike maqedonase për energjetikë dhe politikën aktuale energjetike**

##### **4.1. Strategjia për Zhvillimin e Energjetikës së Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2030**

Objektivat që i përcakton Republika e Maqedonisë në këtë Strategji mbështeten në bazë të objektivave të BE-së, duke i pasur parasysh karakteristikat e veçanta të vendit. Duke e marrë parasysh intensitetin e lartë energjetik, Republika e Maqedonisë planifikon një përmirësim gjithëpërfshirës të efikasitetit energjetik në sektorin e prodhimit, transmetimit dhe shfrytëzimit të energjisë. Strategjia për objektiv e përcakton reduktimin e intensitetit për 30% deri në vitin 2020, në krahasim me intensitetin energjetik në vitin 2006. Pjesëmarrja e burimeve të rinovueshme energjetike në vitin 2020 aktualisht është parashikuar të jetë 21% nga konsumi i përgjithshëm i energjisë finale. Njëkohësisht, planifikohet që pjesëmarrja e bio-karburanteve në konsumin e përgjithshëm të diselit dhe karburanteve të benzinës të arrijë 10% deri në vitin 2020.

Republika e Maqedonisë shpenzon shumë pak energji primare për kokë banori. Konsumi i energjisë finale për

kokë banori është po ashtu i vogël. Kështu që, në vitin 2006, ai ka qenë 33 herë më i vogël nga konsumi mesatar në vendet e Evropës të cilat janë anëtare të OECD dhe për 35% më i ulët nga mesatarja e vendeve të Evropës të cilat nuk janë anëtare të OECD. Ky parametër do të mbetet i ulët edhe në vitin 2020, madje edhe nëse Republika e Maqedonisë arrin një rritje prej 3% të konsumit të energjisë finale në nivel vjetor.

Nevojat e **gazit natyror** do të rriten deri në 1350 milionë Nm<sup>3</sup> (1083 ktoe) në vitin 2030. Në këtë konsum nuk janë marrë parasysh dy elektranat koogjeneruese të planifikuara të gazit TE-TO Shkup dhe Shkup Veri SHA, me konsum të përgjithshëm të gazit natyror prej 390 milionë Nm<sup>3</sup> (313 ktoe) në nivel vjetor, si dhe një numër i caktuar i kapaciteteve të planifikuara të vogla. Duke e pasur parasysh se deri në atë periudhë do të realizohet lidhja rajonale me gazsjellës të ri, nuk përjashtohet ndërtimi i objekteve të planifikuara, me ç'rast **konsumi i përgjithshëm i gazit natyror, deri në vitin 2030, do të ishte rreth 1800 milionë Nm<sup>3</sup> (1445 ktoe) në nivel vjetor.**

Theksi është vënë mbi përmirësimin e shfrytëzimit të energjisë në të dyja anët: rezervat energjetike dhe shfrytëzimi maksimal. **Opcionet e rezervave energjetike do të përforcohen nëse dhe kur do të arrihen marrëveshje afatgjata për furnizim me gaz përmes gazsjellësve ekzistues**, si dhe me një shfrytëzim më të madh të burimeve të rinovueshme energjetike. Zgjerimi i rrjetit të gazit natyror, mes tjerash, është një element i rëndësishëm themelor në realizimin e të gjitha masave të parashikuara për efikasitet energjetik.

##### **4.2. Strategjia për Avancimin e Efikasitetit Energjetik deri në vitin 2020**

Objekivi i Strategjisë për Avancimin e Efikasitetit Energjetik në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2020 është zhvillimi i kornizës për miratimin e shpejtuar të praktikave për efikasitet energjetik në mënyrë të qëndrueshme, përmes zbatimit të një sërë programesh dhe iniciativash lidhur me reduktimin e varësisë nga importi i energjisë, intensitetin energjetik, përdorimin joproduktiv të energjisë elektrike, krijimin e kushteve të përshtatshme për rritjen e përfshirjes dhe mundësive të sektorit privat, në mënyrë plotësuese me aktivitete për promovim dhe trajnime.

Ky dokument gazifikimin e apostrofon jo vetëm në dritën e përdorimit të burimeve të energjisë, përkundrazi masa



kryesore është efikasiteti më i madh energjetik i aparateve/pajisjes tek shfrytëzimi final.

Gazifikimi do të garantojë rritje të konsiderueshme të EE tek shfrytëzimi final. Amvisëritë do të kenë mundësi të shfrytëzojnë aparate me performansa më të volitshme. Ato përfshijnë:

- kaldaja me kondensim me efikasitet prej përafërsisht 99%;
- zëvendësimin e sobave të cilat shfrytëzojnë vaj të lehtë me soba me gaz tek kaldajat individuale për ngrohje qendrore nëpër objekte;
- prodhim të njëhershëm të energjisë termike për ngrohje dhe ujit të ngrohtë sanitar me impiante kaldajash të cilësisë së lartë;
- aplikimin e sistemeve për prodhim të kombinuar me vëllim të vogël (koogjenerim).

Shfrytëzimi i gazit natyror për ngrohje individuale ka përparësi para furnizimit të centralizuar me energji termike (sistemi i ngrohjes qendrore) prej më së paku 8-12% (humbja e energjisë termike në rrjetin e shpërndarjes, humbja e ujit, energji e shpenzuar për motorët e pompave për qarkullim).

Zëvendësimi i energjisë elektrike me gaz është një përfitim i rëndësishëm ekonomik dhe ekologjik. Theksohet se 85% e energjisë elektrike prodhohet në termocentrale, ku për çdo kWh energji elektrike të prodhuar shpenzohen 3 kWh energjens dhe emetohet rreth 1kgCO<sub>2</sub>.

Zbatimi i masave për efikasitet energjetik, të cilat janë përcaktuar në këtë Strategji, pritet të shoqërohen me një zhvillim të shpejtë të rrjeteve për transmetim dhe shpërndarje të gazit natyror në më shumë qytete të Republikës së Maqedonisë, bashkë me masat stimuluese financiare për pronarët e shtëpive që të instalojnë kolektorë diellorë, pompa termike gjeotermale dhe t'i rikonstruojnë objektet e vjetra.

## 5. Republika e Maqedonisë: Politikat e shfrytëzimit të gazit natyror

Komuniteti Energjetik i BE-së dhe palët kontraktuese, duke e përfshirë edhe Republikën e Maqedonisë, u angazhuan për përmirësimin e gjendjes së mjedisit jetësor edhe atë nga aspekti i gazit natyror dhe energjisë elektrike, efikasitetit energjetik dhe burimeve të rinovueshme energjetike, duke e marrë në konsideratë se për t'u arritur këto objektiva, duhet të inkorporohet një strukturë rregullatore gjithëpërfshirëse dhe e integruar

në treg, e mbështetur nga institucione të fuqishme dhe monitorimi efektiv, si dhe me një përfshirje përkatëse të sektorit privat.

Depërtimi i shpejtë i gazit natyror në ekonominë e Republikës së Maqedonisë do ta reduktojë konsumin e hidro-produkteve të naftës. Do të reduktohet edhe konsumi i vajit të lehtë (D2), i cili përdoret në sektorin rezident dhe komercial, pjesërisht në industri dhe në një pjesë më të vogël në sektorin e transportit, në bazë të projektit se autobusët si karburant do të përdorin gaz të kompresuar natyror (GKN). Përveç konsumit të reduktuar energjetik kjo do të rezultojë edhe me përfitime të rëndësishme sa i përket mbrojtjes së mjedisit jetësor.

Në përputhje me dokumentet strategjike nevoja e vlerësuar për gaz natyror në vitin 2020 është në nivel prej 7800 GWh e që e nënkupton sasinë e gazit natyror në shumë prej 850 milionë Nm<sup>3</sup>.

Shfrytëzimi i gazit natyror nëpër amvisëri, në vitin 2020, pritet se do të arrijë një vlerë prej 793 GWh (85•106Nm<sup>3</sup>). Parashikohet se përafërsisht 57000 amvisëri do të lidhen në sistemin e furnizimit me gaz natyror, i cili do të shfrytëzohet për ngrohje, ngrohjen e ujit sanitar dhe për gatim. Në vitin 2020 gazi natyror do të merr pjesë në konsumin e energjisë në amvisëritë me përafërsisht 9%. Në periudhën e analizuar gazi natyror do ta rrisë pjesëmarrjen e vet në këtë sektor KOMERCIAL deri në 76-95 GWh (8•106Nm<sup>3</sup>, 6.53 ktoe).

Me realizimin e rrjetit të gazit, hapen edhe rrugë të tjera për shfrytëzimin efikas të gazit si karburant në impiante të vogla koogjenerimi. Parimi i koogjenerimit mund të aplikohet në të gjitha ato vende në të cilat ekziston nevojë e njëkohshme për energji elektrike dhe termike. Për shkak të transportit të lehtë të energjisë elektrike mund të konkludohet se është e nevojshme të ekzistojë vetëm nevojë e vazhdueshme nga energjia termike, ndërsa energjia e prodhuar elektrike çdoherë mund të merret nga rrjeti i EVN Maqedoni. Kjo veçanërisht ka të bëjë me prodhuesit e vegjël.

Së këtejmi, mundësohet shfrytëzim efikas i karburantit, dhe me këtë edhe reduktim të emisionit të materieve të dëmshme në ajër, reduktim të humbjeve për shkak të transportit të energjisë elektrike dhe termike nga prodhuesi deri te konsumatori. Impiantet janë relativisht të leverdishme dhe fleksibile, ndërsa përzgjedhja e llojit të impiantit, para së gjithash, varet nga dedikimi i objektit në të cilin përdoren. Këtu, para së gjithash, merren në konsideratë motorët me gaz (disel dhe oto cikli) të cilët në mënyrë efikase mund të përdoren në spitale, kazerma ushtarake, objekte administrative dhe

ngjashëm. Një shembull pozitiv është studimi i filluar për përcaktimin e mundësisë potenciale për instalimin e impiantit koogjenerues, është Qendra Klinike në Shkup.

Edhe pse në dokumentin strategjik është nënvizuar nevoja e shfrytëzimit të rritur të gazit natyror në ekonominë e Republikës së Maqedonisë, vite me radhë është evidente ngecja e depërtimit të këtij burimi energjetik në indin e ekonomisë së Shtetit.

Shkaqet kryesore, të cilat kontribuojnë për një gjendje të këfillë janë të karakterit financiar dhe teknik. Si shkak i parë ishte/është dallimi i pakonsiderueshëm midis çmimit të energjisë nga gazi natyror dhe çmimit të depresuar të energjisë elektrike, i cili pjesërisht është i mbrojtur si kategori sociale (Foto 5).




Foto 5. Lëvizja e çmimeve të burimeve të caktuara energjetike

Shkak tjetër është edhe nevoja e investimeve të konsiderueshme financiare për pajisje të re dhe aparate të cilat do ta shfrytëzojnë gazin si burim energjetik. Çmimin, të cilin shfrytëzuesi potencial duhet ta paguajë për lidhje në rrjetin shpërndarës të gazit, nuk është edhe aq i lartë. Gjatë konvertimit nga një burim energjetik (energji elektrike, hidro-karburant, etj.) në gaz natyror nevojiten investime plotësuese financiare për blerjen e pajisjes e cila do të mundësojë që ta shfrytëzojë gazin natyror – sobë e re për gatim, bojler për ujë të ngrohtë sanitar, lloj i frigoriferit absorbues, kalorifer me gaz, nëse amvisëria nuk posedon ngrohje individuale qendrore. Megjithatë, edhe në këtë rast, më lirë do të kalojnë ata konsumatorë të cilët kanë kaldaja me hidro-karburant dhe do të kenë nevojë të blejnë vetëm një sobë të re. Nëse shfrytëzuesit kanë kaldajë me energji elektrike, duhet të investojnë edhe në impiantin e ri për kaldaja. Ndërkaq, këto nuk janë sfidat e përgjithshme. Shfrytëzuesi potencial duhet të posedojë edhe një oxhak përkatës për emetimin e produkteve nga procesi i djegies.

Arsyeja kryesore për zhvillimin e pamjaftueshëm të rrjetit shpërndarës shkaktohet edhe nga nevoja e mjeteve të konsiderueshme financiare të cilat duhet të investohen në ndërtimin e sistemit shpërndarës nëpër qytetet në afërsinë e të cilëve kalon linja ekzistuese e transportit-transmetimit të gazit. Investimi në energjetikë çdoherë është profitabil, por me një periudhë të gjatë të kthimit të mjeteve të investuara. Kjo nënkupton se duhet të gjendet investitorë me kondicion të mirë financiar, që të mund të përballojë disa vjet të punojë me humbje. Investitori i këfillë duhet të ketë kapacitete financiare që t'u ofrojë amvisërive kredi të buta për furnizimin e pajisjes së nevojshme për shfrytëzimin e gazit natyror. Ai duhet të ketë përvojë në projektimin e sistemeve shpërndarës dhe në ndërtimin e tyre të sigurt. Duhet të posedojë edhe laboratorë përkatës për kontrollin e pajisjes që do të përdoret, si dhe me qendra për trajnimin e montuesve të ardhshëm të rrjeteve shpërndarëse dhe instalimeve nëpër amvisëri. Duhet të ketë përvojë dhe ekip për intervenime të shpejta në rast të defekteve në sistemet e gazifikimit – rrjetin shpërndarës ose tek amvisëritë individuale. Ai duhet të përgatis plane dhe procedura (por edhe të ketë përvojë) si të përballat me situata krize (shpërthime, tërmete).

Pushteti lokal (komunat) që u angazhua për zhvillimin dhe organizimin e rrjetit shpërndarës nuk ka kapacitete të mjaftueshme as financiare e as burime njerëzore. Njëra nga mundësitë optimale – hyrja e kapitalit të huaj, i cili me vete do ta sjellë moton "e di – si", u pamundësua me "cunamin financiar" që ndodhi para disa vitesh. Të gjithë investitorët potencial u bënë tepër të kujdesshëm gjatë përzgjedhjes së lokacionit për investime financiare, ndërsa Qyteti i Shkupit, madje edhe e tërë Republika e Maqedonisë, megjithatë kanë kapacitet të vogël për "lojtarët e mëdhenj". Njëri nga shkaqet, i cili e prolongoi depërtimin më të shpejtë të gazit natyror, është edhe çështja e pazgjidhur në tërësi e marrëdhënieve pronësore-juridike të kompanisë GAMA, e cila e posedon licencën për transportin e gazit.

Qeveria e ka të qartë se duhet të sigurojë kushte për furnizim afatgjatë me sasi të mjaftueshme të energjisë nga importi edhe atë krahas hidro-karburanteve edhe me gaz natyror. Për këto shkaqe përveç përpilimit të dokumentacionit studimor dhe teknik, janë ndërmarrë edhe disa hapa konkret si vijojnë:

- Janë harmonizuar aktet normative me kërkesat të cilat i parashtroi Bashkimi Evropian përmes Komuniteti Energjetik.





- U arrit marrëveshje me Rusinë për kthimin e borxhit prej 60 M\$ në formë të pjesëmarrjes së firmave nga Rusia në ndërtimin e korridoreve transportues.
- Është arritur marrëveshje për furnizimin afatgjatë me sasi të mjaftueshme të gazit midis Republikës së Maqedonisë dhe Ruisë.
- Republika e Maqedonisë nënshkroi Memorandum me Azerbajxhanin për bashkëpunim në fushën e energjetikës.

Qeverisë i mbetet të ndërmerr edhe një hap në drejtim të miratimit të amendamentit në Ligjin për energjetikë, i cili ka të bëjë me përcaktimin e qartë të vendit<sup>6</sup> në të cilin tubacioni transportues magjstral kalon në rrjetin shpërndarës. Qëndrimi ynë është se çdo konsumatorë, që është lidhur në tubacion në të cilin presioni është më i ulët se 24 bare, do të thotë se është lidhur në rrjetin shpërndarës. Kjo ka të bëjë edhe me impiantet industriale dhe energjetike të lidhura deri më tani, të cilat kanë status të objekteve "të lidhur në rrjetin e transmetimit". Kjo dispozitë ligjore, e cila me ligj do t'i barazojë të gjithë konsumatorët e lidhur në rrjetin e gazifikimit në juridiksionin e qytetit, do të sigurojë kushte që për koncesioner ose NPP të paraqitet partner cilësor. Me këtë krijohen kushte që të mundet në mënyrë cilësore ta planifikojë konsumin në rrjetin shpërndarës përmes shfrytëzimit të vazhdueshëm të gazit nga ana e subjekteve ekonomike, të cilët do ta kompensojnë natyrën stohastike të shfrytëzimit të gazit nga ana e amvisërive.

Në këtë periudhë kohore është shpallur thirrja publike për koncesioner për ndërtimin e rrjetit shpërndarës të gazit natyror në rajonin e Shkupit. Parandjenja jonë është se koncesioneri potencial do të kërkojë plotësime dhe ndryshime të kushteve të koncesionimit të cilat janë shpallur publikisht, që të mund të sigurojë justifikim ekonomik të investimit të tij. Megjithatë, nëse nënshkruhet marrëveshje sipas kushteve ekzistuese të tenderit, kjo do të thotë se dyshimet tona nuk kanë qenë të arsyeshme dhe se kemi bërë parashikim të gabueshëm.

## 6. Aspekti i furnizimit afatgjatë me energji

Sigurimi afatgjatë i furnizimit të sigurt me gaz varet nga politikat dhe kushtet ekonomike. Për momentin, pozita e Republikës së Maqedonisë, në zemër të Gadishullit

Ballkanik, nuk paraqet përparësi por mangësi. Ajo tani është një shfrytëzuese e vogël dhe përfundimtare e gazit, gjë që kontribuon çmimi i tij për shfrytëzuesit të jetë më i larti në Evropë. Sipas analizave për lëvizjen e gazsjellësve magjstral me perspektivë, Republika e Maqedonisë nuk gjendet në asnjë linjë. Sërish ajo mund të lidhet vetëm me një degë të gazsjellësve magjstral, të cilët kalojnë më afër apo më larg kufirit nacional.

A ka në treg sasi të mjaftueshme të gazit natyror? Dhe, cilët janë furnizuesit kryesorë?

Mundësia potenciale për Republikën e Maqedonisë është të lidhet në gazsjellësin magjstral, Rrjedha Jugore ose në Gazsjellësin Trans-Adriatik (TAP). Në rastin e parë gazi natyror merret nga Rusia (Gasprom), ndërsa në rastin e dytë nga konzorciumi i cili furnizohet me gaz natyror nga burimi Shah-Deniz II në Azerbajxhan. Si vende të cilat posedojnë rezerva të gazit natyror është e njohur Federata Ruse dhe Azerbajxhani. Rezerva të konfirmuara të gazit, në fund të vitit 2012, në Federatën Ruse janë 32.9 trilion metra kub gaz (17.6 % pjesëmarrje në rezervat e përgjithshme botërore), ndërsa në Azerbajxhan 0.9 trilion metra kub gaz (0.5 % pjesëmarrje në rezervat e përgjithshme botërore). Karakteristikë më e rëndësishme është kapaciteti prodhues dhe në këtë drejtim Federata Ruse, në fund të vitit 2012,<sup>7</sup> merr pjesë me 592.3 bilion metra kub gaz, ndërsa Azerbajxhani me 15.6 bilionë metra kub gaz, prej të cilave për nevojat e veta shpenzon 8.5 bilionë.




Foto 6. Shpërndarja e rezervave të konfirmuara të gazit natyror në vitin 2012 në %

<sup>6</sup> Skopje' Natural Gas Network – A Measure To Implement Energy Efficiency Strategy, Prof. d-r Konstantin Dimitrov, Jasminka Kapac, BSc, Ass. M-r Ognen Dimitrov, INGAS International Symposium on Natural Gas - The Balkans 2010, Skopje/ Macedonia

<sup>7</sup> BP Statistical Review of World Energy June 2013




Foto 7. Prodhimi i gazit natyror sipas rajoneve (109 m³)

Lidhja në gazsjellësin magjistrat **Rrjedha Jugore (South Stream)** dukej optimale, meqë kalonte shumë pranë vijës kufitare juglindore të Republikës së Maqedonisë<sup>8</sup>. Megjithatë, kjo degë jugore e Rrjedhës Jugore është prolonguar (anuluar), ndërsa të gjitha angazhimet janë bërë për ndërtimin sa më të shpejtë të degës Veri-Perëndimore, e cila është me interes absolut për Rusinë. Me këtë linjë, sigurohet një pozitë pseudo-monopoliste e Rosisë (GASPROM) në Evropën Perëndimore, meqë në mënyrë të drejtpërdrejtë pamundësohet ndërtimi i linjës konkurrenente NABUKO. Eliminimi i gazsjellësit NABUKO nuk u realizua vetëm për shkak të ndërtimit më të shpejtë të gazsjellësit Rrjedha Jugore por për shkak se konzorciumi, i cili e realizoi NABUKO, nuk arriti të sigurojë burime për furnizimin me gaz. Ata ishin në një konkurrencë të drejtpërdrejt me konzorciumin TAB, i cili gjatë vitit 2013 siguroi një marrëveshje afatgjatë me koncesionerët e burimit Shah-Deniz II (në Detin Kaspik). Këtë burim e menaxhon kompania aksionare në të cilën kapitalin dominant e ka Shteti i Azerbajxhanit, ndërsa partner është konzorciumi i gazsjellësit TANAP.



Foto 8. Linjat magjistrale të gazsjellësit Rrjedha Jugore

Për Republikën e Maqedonisë lidhja në degën Veri-Perëndimore të Rrjedhës Jugore është mjaft e vështirësuar, në krahasim me Degën Jugore të supozuar. Kjo, para së gjithash, ka të bëjë me distancën (mbi 200 km) nga kufiri i Maqedonisë. Ndërkaq, nëse ndërtohen linja për furnizimin e qyteteve jugorë të Serbisë (Nish), hapen shumë çështje sensitive sa i përket financimit të kësaj lidhjeje. Duhet të analizohet me kujdes edhe lidhja në anën e Bullgarisë, paralelisht me lidhjen ekzistuese aktuale.

Lidhja në Veri në perspektivë mund të perceptohet pozitivisht për shkak të lidhjes në unazën e gazit me vendet fqinje: Shqipërinë, Malin e Zi dhe Kosovën (Foto 9). Lidhja në anën Lindore mundëson lehtësim të pjesshëm sa u përket obligimeve të eksproprijimit të tokës për korridorin nëpër të cilin duhet të kalojë gazsjellësi. Ky obligim tanimë është realizuar gjatë ndërtimit të seksionit nga kufiri i Bullgarisë deri në Shkup.

Gjithashtu, edhe dimensionin kohor nuk është përcaktuar edhe pse parashikohet që Rrjedha Jugore të jetë funksionale në vitin 2015, ndërsa për lidhjen e Republikës së Maqedonisë me këtë magjistrale, e cila kalon nëpër Serbi, do t'i duhet një periudhë e konsiderueshme kohore për realizimin e së njëjtës.

Karakteristikat themelore të gazsjellësit Rrjedha Jugore janë si vijojnë:

*Investimi i përbashkët Rrjedha Jugore AG<sup>9</sup>, në pronësi të barabartë të Gasprom-it dhe Eni-t, u regjistrua më 18 janar të vitit 2008 në Zvicër. Megjithatë, më 16 shtator të vitit 2011 u firmos marrëveshje aksionare ndërmjet Gasprom, Eni, Elektroekonomisë së Francës (EDF) dhe Uintershell që të themelohet kompani e re projektuese Rrjedha Jugore Transport AG për pjesën e Detit të Zi të gazsjellësit.*

*Më 28 dhjetor të vitit 2011, Turqia e nënshkroi marrëveshjen përfundimtare duke lejuar që gazsjellësi të kalojë nëpër ujërat e saj territorial. Vendimin përfundimtar për investime të pjesës serbe u nënshkrua më 29 tetor të vitit 2012, për pjesën hungareze më 2 nëntor të vitit 2012, për seksionin e Sllovenisë më 13 nëntor 2012 dhe për pjesën e Bullgarisë më 15 nëntor të vitit 2012.*

*Më 25/07/2013 Nënkrjetari i Qeverisë dhe Ministër i Financave të Republikës së Maqedonisë, z. Zoran*

<sup>8</sup> Development Of The Application/Use Of Natural Gas, K. Dimitrov, J. D. Kapac, O. Dimitrov, Geopolitics of Natural Gas and Supply Security, 5 International Symposium on Natural Gas, IN-GAS 2013, Istanbul

<sup>9</sup> <http://www.south-stream.info/en/pipeline/route/>

Stavrevski nënshkroi marrëveshje për ndërtimin e seksionit Rrjedha Jugore nëpër Republikën e Maqedonisë. Kompania nacionale për shpërndarjen e gazit "Resurse Energjetike Maqedonase" do të punojë bashkë me Gasprom në zgjidhjen teknike për trajektoren e degës së gazsjellësit që kalon nëpër vendin tonë.

Pjesa ruse në tokë do të startojë nga stacioni i kompresimit të gazit "Poçinki" deri në stacionin e kompresimit të gazit "Ruskaja" në afërsi të Anapa. Pjesa nëndetare, në gjatësi prej 925 kilometra, do të startojë nga stacioni i kompresimit të gazit "Ruskaja" përmes Detit të Zi deri në qytetin Varna në Bullgari. Seksioni, në gjatësi prej 1455 kilometra, në tokë fillon nga Varna dhe shkon deri në Plevni. Prej këtu, linja jugperëndimore ishte paraparë të vazhdonte përmes Greqisë dhe Detit Jon deri në Italinë Jugore. Megjithatë, kjo linjë u braktis. Linja veriperëndimore do të vazhdojë nga Plevni drejt Serbisë. Nga Subotica gazsjellësi do të kalojë përmes Hungarisë dhe Sllovenisë deri në Arnoldste të Austrisë në afërsi të kufirit të Italisë, për furnizimin e Italisë Veriore. Dy linja janë parashikuar për Kroacinë dhe Bosnjë e Hercegovinën.

Gazsjellësi planifikohet të transmetojë 63 miliardë metra kub gaz natyror në nivel vjetor. Ai do të posedojë katër linja paralele me kapacitet prej 15.75 miliardë metra kub për secilën. Në bregun e gazsjellësit do të përdoren tubacione me diametër prej 810 milimetra, të dedikuara të punojnë nën presion prej 27,73 megapaskal dhe me një trashësi të mureve të tubacionit prej 39 milimetrash. Seksionet e gazsjellësit në Bullgari, Serbi, Hungari dhe Slloveni do të kenë një kapacitet prej më së paku 10 miliardë metra kub në nivel vjetor. Në tokë, gazsjellësi do të posedojë tetë stacione të kompresimit të gazit. Më së paku do të ndërtohen dy objekte për magazinimin e gazit prej të cilëve njëri do të jetë objekt për magazinim nëntokësorë në Hungari, me kapacitet minimal prej 1 miliard metra kub, ndërsa tjetri në Banatski Dvor në Serbi me kapacitet prej 3,2 miliardë metra kub.

Me interes të veçantë është projekti **TAP (Trans Adriatik Pipeline)** trajektorja magjistrale e të cilit (Foto 9) kalon në një distancë më të vogël prej 50 km nga vija kufitare Maqedoni – Greqi.

Lidhja me këtë gazsjellës magjstral nga aspekti teknik do të mund të realizohet vetëm për shkak se nuk ka male në atë rrugë, përkatësisht ndiqet rrjedha e Lumit Vardar.

Lidhja me këtë projekt ka përparësi strategjike por edhe mangësi. Përveç distancës së vogël nga kufiri, sigurohet hyrje nga një drejtim tjetër dhe mundësohet furnizimi me

gaz nga dy drejtime të ndryshme. Përparësia e dytë e madhe është se në këtë rast operator nuk është kompania e njëjtë (GASPROM). Me këtë mundësohet konkurrencë të dy furnizuesve dhe eventualisht çmime më të ulëta për konsumatorët maqedonas. Një mangësi e vogël në krahasim me Rrjedhën Jugore është meqë hyrja e tij në funksion parashikohet pas vitit 2018.

Rezervimi më i madh ndaj këtij projekti rezulton nga fakti se lidhja duhet të realizohet tek fqinji ynë jugor Greqia, e cila ka problem politik me emrin tonë kushtetues Republika e Maqedonisë. Edhe pse çdoherë theksohet se projektet ekonomike nuk njohin kufi, në këtë rast Republika e Maqedonisë ka një përvojë të hidhur dhe të pakëndshme.



Foto 9. Seksioni magjstral i TAP dhe formimi potencial i unazës së gazsjellësit

Karakteristikat themelore të Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) janë si vijojnë:

Gazsjellësit Trans Adriatik<sup>10</sup> do të jetë furnizues me gaz natyror nga faza e dytë e vendburimit të gazit që është në zhvillim Shah Deniz në pjesën e Azerbajxhanit të Detit Kaspik përmes Gazsjellësit Kaukazi Jugor dhe Gazsjellësi i planifikuar Trans Anadolian (TANAP). Duke arritur në kufirin perëndimor të Turqisë, gasi i Azerbajxhanit mund të riorientohet përmes linjës së projektit TAP Greqi-Shqipëri-fundi i Detit Adriatik-Itali-Zvicër. Projekti është disenjuar që të mund të rritet kapaciteti transportues nga 10 deri në 20 miliardë metra kub në nivel vjetor, varësisht nga oferta dhe kërkesa.

Shanset e TAP u përmirësuan në masë të konsiderueshme, kur Moskë vendosi të heq dorë nga linja jugore e Rrjedhës Jugore, e cila kalonte nga Greqia përmes fundit të Detit Adriatik në Itali. Tërheqja e Gasprom-it nga ky projekt ndihmoi që të pastrohet konkurrenca në mënyrë që TAP të mund të arrijë deri në tregun e Italisë. Në mënyrë të njëjtë kontribuoi në drejtim të intensifikimit të konkurrencës midis TAP-

<sup>10</sup> <http://www.trans-adriatic-pipeline.com/tap-project/>



*Nabuko për gazin e Azerbajxhanit dhe për përzgjedhjen e trajektores eksportuese.*

*Konzorciumi TAP e përfshiu Statoil Norvegji me 42,5 për qind të aksioneve, AHRO nga Zvicra (holding nga kompanitë energjetike të disa kantoneve zvicerane) me 42,5 për qind dhe E.ON Ruhrgas me 15 për qind. Promotori kryesor i TAP-it është Statoil, i cili njëkohërisht është partner i Shah-Deniz partner i vetëm i cili njëkohësisht posedon aksione në projektin për nxjerrjen e gazit dhe projektin e gazsjellësit, nga fillimi i të dy projekteve e deri më sot. Në qershor të vitit 2013 projekti u përzgjedh si linjë e transportit të gazit nga Shah-Deniz II në raport me projektin konkurrues Nabuko Perëndim. Më vonë gjatë vitit, BP, SOCAR, Total, dhe Fluxys u bënë aksionar të këtij projekti.*

*Gazsjellësi fillon në kufirin Greqi-Turqi Kipoi, Evros, ku do të lidhet me Gazsjellësin Trans Anadolian. Ai do të kalojë përmes Greqisë, Shqipërisë dhe Detit Adriatik dhe do të arrijë në Bregun e Italisë në afërsi të San Foca. Gjatësia e përgjithshme e gazsjellësit do të jetë 867 kilometra prej të cilave 547 kilometra në Greqi, 211 kilometra në Shqipëri, 104 kilometra në fundin e detit dhe 5 kilometra në Itali. Në fundin e detit gazsjellësi do të vendoset në thellësi maksimale prej 810 metra.*

*Kapaciteti fillestar i gazsjellësit do të jetë rreth 10 miliardë metra kub gaz natyror në vit, me opsion për zgjerimin e kapacitetit deri 20 miliardë metra kub. Ai do të shfrytëzojë tubacione me një diametër prej 1200 mm nën presion prej 95 bare në pjesën e tokës dhe 910 mm tubacione nën presion prej 145 bare në pjesën nënujore. TAP, gjithashtu, planifikon të zhvillojë magazinim nëntokësor të gazit natyror në Shqipëri që të sigurohet një rrjedhë reversibile me mundësi prej 8,5 miliardë metra kub.*

Si mundësi e tretë potenciale është edhe lidhja në gazsjellësin ekzistues magjstral Rusi-Turqi, me linjë të dytë paralele. Nga aspekti teknik kjo është zgjidhja më e volitshme – është zgjidhur trajektorja e gazsjellësit, janë zgjidhur marrëdhëniet pronësore-juridike, lidhja është e shkurtër meqë është në afërsi të drejtpërdrejtë të kufirit Maqedoni-Bullgari. Pengesat të cilat deri më tani pengonin për t'iu qasur kësaj zgjidhjeje konsistojnë në kapacitetin e limituar të këtij gazsjellësi magjstral përmes së cilit livrohesh një sasi e konsiderueshme e gazit natyror në Bullgari, Greqi dhe Turqi. Megjithatë, informatat e fundit vënë në pah reduktimin e sasive të gazit të cilat i merr Turqia përmes kësaj linje (furnizim potencial nga Rajoni Kaspik dhe Irani), kështu që mund

të lirohen kapacitete për nevojat e Republikës së Maqedonisë. Është e qartë se ana negative e kësaj zgjidhjeje konsiston me atë se furnizimi bëhet nga një livruer dhe se nuk ka konkurrencë por gjendje monopoli.

Në asnjë rast nuk guxon të shpërfilllet potenciali të cilin e ofrojnë rrjetet virtuale të gazsjellësve. Një shembull i realizuar është qyteti i Strumicës. Parashikojmë se brenda këtij viti në treg do të ofrohet furnizimi me gaz natyror të kompresuar për nevojat e impianteve industriale dhe objekteve shoqërore, veçanërisht qendrave klinike dhe shkollave. Përfitimet janë të natyrës financiare, për shkak të dallimit të ndjeshëm të energjisë që e përmban vaji i lehtë (nafta) dhe gazi i kompresuar natyror. Përfitimi i dytë është reduktimi i emisionit të materieve të dëmshme në mjedisin jetësor. Mundësia e tretë potenciale ka të bëjë me objektet të cilat kanë nevojë të njëkohshme për energji elektrike dhe termike për gjatë gjithë vitit (siç janë spitalet) të zbatojnë sisteme koogjenerimi.

Investimet lidhur me përshtatjen e pajisjes për shfrytëzimin e gazit natyror janë minimale. Ndërsa, kur gazi natyror do të mbërrijë në atë rajon përmes tubacioneve transportuese dhe shpërndarëse, atëherë vetëm lidhet me të njëjtët. Investimi paraprak për përshtatjen e pajisjes nuk humbet.

Objektiv strategjik i Republikës së Maqedonisë është edhe lidhja me shtetet fqinje si Kosova dhe Shqipëria. Veçanërisht është e rëndësishme lidhja me Shqipërinë (Korridorin 8) për shkak të mundësisë potenciale në një kohë të ardhme në portet e saj të ndërtohen terminale për gaz të lëngshëm natyror (GLN).

Analiza mbi potencialin e shfrytëzimit të gazit të lëngshëm natyror, edhe pse është atraktive dhe teknikisht e realizueshme, konsiderojmë se në periudhën e ardhshme nuk do të jetë me rëndësi prioritare për Republikën e Maqedonisë. Para së gjithash në rajonin tonë ekziston vetëm një terminal për gaz të lëngshëm, deri tek i cili mund të qasemi vetëm përmes rrugës detare. Kjo do të thotë se duhet të ndërtohet terminal i pranueshëm në lokacion deri tek i cili do të arrihet përmes komunikacionit hekurudhor ose rrugor.



## PJESA II – KUADRI LIGJOR – PASQYRA

Si pikë referimi për pasqyrën e kuadrit ligjor të Republikës së Maqedonisë, sa i përket sektorit të gazit natyror, është Direktiva e BE 2009/73/KE nga 13 korriku 2009 për rregullat e përbashkëta të tregut të brendshëm të gazit natyror. Direktiva, në mënyrë të qartë, i përcakton rregullat e përbashkëta për transmetimin, shpërndarjen, furnizimin dhe magazinimin e gazit natyror. Marrë në përgjithësi, sipas kësaj mase, sektori mund të analizohet në tre pjesë, edhe atë: prodhim, transport dhe shpërndarje të gazit natyror. Pikërisht për këtë shkak në Ligjin për energjetikë në mënyrë të qartë janë përkufizuar nocionet që kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e sektorit, qasjen deri në treg, kriteret, transportin dhe shpërndarjen e gazit natyror, ndërsa e gjitha kjo në përputhje me Direktivën.

### 1. Kuadri ligjor – pasqyra

Republika e Maqedonisë e konstruktivoi kuadrin ligjor për energjetikë sipas objektivave dhe kërkesave të Bashkimit Evropian, gjithsesi të përshtatur me nevojat e brendshme dhe me nevojat e tregut dhe së këtejmi e rriti rëndësinë e energjetikës si njërin nga promotorët kryesor të ekonomisë. Sektori i energjetikës pranë Ministrisë së Ekonomisë së Republikës të Maqedonisë është përgjegjës për implementimin e politikës energjetike dhe zhvillimin e sektorit energjetik në vend. Si organ ndihmës për mbështetje në punën e Ministrisë, në vitin 2005, u themelua Agjencia për Energjetikë (AERM) edhe pse në mënyrë aktive filloi të punojë në vitin 2007 dhe e njëjta ka cilësinë e personit juridik.

#### • Ligji për energjetikë

Ligji për energjetikë e rregullon tregun e gazit natyror, me qëllim të furnizimit të sigurt dhe cilësor të konsumatorëve me energji dhe burime energjetike dhe integrimin e tregjeve energjetike të Republikës së Maqedonisë në tregjet energjetike rajonale dhe ndërkombëtare, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare<sup>11</sup>. Ligji për energjetikë e trajton: transmetimin e gazit<sup>12</sup>, menaxhimin me sistemin e

transmetimit të gazit natyror<sup>13</sup>, shpërndarjen e gazit natyror<sup>14</sup>, furnizimin në rast të fundit me gaz natyror<sup>15</sup>, furnizimin me gaz natyror dhe tregtinë me gaz natyror. Neni 3 i Ligjit në mënyrë të qartë e përkufizon rëndësinë e shprehjeve themelore të energjisë, përkatësisht të gazit natyror.

*(110) Transporti i gazit natyror nënkupton transmetimin e gazit natyror përmes gazsjellësve ose formave të tjera të transportit, siç janë autobotat ose bombolat hekurudhore si dhe mjetet tjera transportuese.*

*(19) Shpërndarja e gazit natyror nënkupton transportin e gazit natyror përmes sistemit shpërndarës dhe menaxhimin e sistemit të shpërndarjes të gazit natyror në një rajon të caktuar për shkak të livrimit të gazit natyror deri te blerësit, duke mos e përfshirë furnizimin me gaz natyror.*

Neni 101 e përkufizon furnizimin me gaz natyror, si vijon: Furnizimi me gaz natyror nënkupton shitjen e gazit natyror konsumatorëve dhe mund ta përfshijë tregtinë me gaz natyror.

Tregtia me gaz natyror në mënyrë të hollësishme rregullohet në seksionin VII të Ligjit për energjetikë.

Në këtë seksion përcaktohen përgjegjësitë dhe detyrimet e operatorit të rrjetit të transmetimit, operatorit të sistemit të transmetimit të gazit natyror, operatorit të sistemit të shpërndarjes, furnizuesit me gaz natyror, furnizuesit në rast të fundit me gaz natyror dhe tregtarit me gaz natyror.

Në ndryshimet e reja ligjore<sup>16</sup> nga muaji maj 2013, që kanë të bëjnë me gazin natyror janë bërë ndryshime në pjesën e lidhje së marrëveshjeve për shpërndarjen e gazit natyror dhe energjisë termike. Përkatësisht, në nenin 62, paragrafi (1) "koncesioni i dhënë nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë" është riformuluar

<sup>13</sup> (119) Menaxhimi me sistemin e transmetimit të gazit natyror nënkupton menaxhimin operativ të sistemit të transmetimit të gazit natyror dhe organizimin e tregut të gazit natyror në Republikën e Maqedonisë duke e përfshirë balancimin e sasive të planifikuara dhe livruara të gazit natyror në kohë reale përmes rrjeteve të transmetimit të gazit natyror dhe nuk e përfshin furnizimin me gaz natyror.

<sup>14</sup> Shpërndarja e gazit natyror nënkupton transportin e gazit natyror përmes sistemit shpërndarës dhe menaxhimin e sistemit të shpërndarjes të gazit natyror në një rajon të caktuar për shkak të livrimit të gazit natyror deri te blerësit, duke mos e përfshirë furnizimin me gaz natyror.

<sup>15</sup> Furnizuesi në rast të fundit me gaz natyror është furnizuesi me gaz natyror i cili siguron shërbim publik, furnizim me gaz natyror i cili e siguron shërbimin publik furnizim me gaz natyror të konsumatorëve të lidhur në sistemin e gazit natyror në rastet e përcaktuara me Ligjin për energjetikë.

<sup>16</sup> Ligji për energjetikë ("Gazeta Zyrtare nr. 79/ 2013)

<sup>11</sup> Ligji për energjetikë, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 16/11 dhe 136/11)

<sup>12</sup> Transmetimi i gazit natyror nënkupton transportin e gazit natyror nëpër rrjetin e transmetimit të gazit natyror me qëllim të livrimit të gazit natyror deri tek blerësit, duke mos e përfshirë furnizimin me gaz natyror.



në "Marrëveshje për vendosjen e partneritetit publiko-privat të ndarë nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë" me qëllim të harmonizimit me Ligjin për partneritet publiko-privat.

Me ndryshimet e reja ligjore, lidhur me kompetencat e gazit natyror, përgjegjësitë i ka Qeveria e Republikës së Maqedonisë, përkatësisht pas nenit 166 janë shtuar dy nene të ri. Së këtejmi, neni 166-a thotë se Qeveria do të miratojë Urdhëresa për rregullat teknike për projektim, realizim, vënie në përdorim, funksionim dhe mirëmbajtje të impianteve dhe instalimeve të gazit natyror sipas propozimit të ministrisë. Neni 166-b thotë se Certifikata për vendosjen dhe saldimit të tubacioneve të polietilenit për sisteme të gazsjellësve, e cila është dhënë nga një shtet tjetër, doemos duhet të njihet nga Republika e Maqedonisë me kërkesë të bartësit dhe se do të formohet një komision i veçantë për këtë dedikim edhe pse ndryshimet e reja ligjore nuk e specifikojnë në mënyrë të saktë se kush do t'i zgjedh anëtarët e këtij komisioni<sup>17</sup>.

Me ndryshimet e reja të ligjit në pjesën e gazit natyror kompetencat janë centralizuar, përkatësisht Qeveria e ka detyrimin dhe përgjegjësinë për realizimin e objektivave lidhur me gazin natyror. Me këtë, kompetencat në nivel lokal janë zvogëluar, përkatësisht janë bartur në nivel qendror. Kjo mund t'i vë në pikëpyetje projektet e gazifikimit në nivel lokal dhe nevojitet një pavarësi më e madhe e njësisë të vetëqeverisjes lokale në drejtim të menaxhimit me çështjet lokale<sup>18</sup>.

• **Rregullore për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e sigurt të sistemeve të gazsjellësve prej tubacioneve të polietilenit nën presion deri në 4 bare**<sup>19</sup>

Kjo Rregullore i rregullon normat e ndërtimit, mirëmbajtjes dhe funksionimit të sigurt të sistemeve të gazsjellësve prej tubacioneve të polietilenit nën presion deri në 4 bare<sup>20</sup>. Këto tubacione janë përdorur për transportin e karburanteve të gazit, sipas standardeve nacionale për karburante të gazit të cilat janë harmonizuar me standardet evropiane. Sipas kësaj Rregulloreje, gazsjellësi ka edhe pjesë përbërëse, siç

janë: elementet lidhëse, tubacione, pajisje dhe ngjashëm. Ato gjithashtu duhet të jenë nga polietileni dhe duhet të jenë të shënuara dhe konform standardeve nacionale të harmonizuara me standardet evropiane. Me këtë Rregullore është rregulluar edhe trasimi dhe trajektorja e gazsjellësve si dhe bashkimi dhe lidhja në gazsjellësit.

• **Rregullore për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e sigurt të objekteve, aparateve dhe instalimeve për instalime të brendshme të gazit**<sup>21</sup>

Me këtë Rregullore përcaktohen normat për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e sigurt të instalimeve të brendshme të gazit dhe linjave të jashtme të gazit në të cilat shfrytëzohen gazra të grupit I, II ose IV për presion të ulët deri më 100mbare ose presion të mesëm deri më 1bar<sup>22</sup>.

• **Rregullore për norma teknike për projektimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e kaldajave të gazit**<sup>23</sup>

Kjo Rregullore i përcakton kushtet teknike për projektimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e kaldajave të gazit, me kapacitet të përgjithshëm prej mbi 50 kW. Në dispozitat e përgjithshme të Rregullores theksohet se ajo ka të bëjë me pikat e kaldajave që gjenden në përbërje të objekteve të banimit me numër më të madh të njerëzve në të cilat presioni më i lartë i lejuar i punës së gazit është 100 mbare, po ashtu edhe për pikat e kaldajave, të cilat gjenden në objekte ndërtimore të veçanta, me presion më të lartë pune prej 4 bare dhe për pikat e kaldajave në të cilat përdoret kombinimi i gazit dhe ajrit me presion më të lartë të lejuar prej 0,6 bar. Rekomandojmë dhe do të ishte mirë që kjo Rregullore të "freskohet" (është miratuar para 24 vitesh dhe deri më sot nuk ka pësuar kurrfarë ndryshimi) që të harmonizohet me arritjet e reja teknologjike dhe normat e ekspluatimit.

Përveç Ministrisë së Ekonomisë dhe AERM, si institucione kompetente për implementimin e politikës energjetike në Republikën e Maqedonisë, në vitin 2003 u themelua autoriteti i pavarur juridik, trupi rregullator për energjetikë - **Komisioni Rregullator për Energjetikë (KRRE)**. Ky Komision rregullon çështje që kanë të bëjnë me veprimtaritë energjetike të përcaktuara me Ligjin për

<sup>17</sup>Marrë nga Analitika - Analizë e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për energjetikë nga muaji maj 2013, f. 5

<sup>18</sup>Marrë nga Analitika - Analizë e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për energjetikë nga muaji maj 2013, f. 8

<sup>19</sup> ("Gazeta Zyrtare nr.100/2009

<sup>20</sup> Gazsjellësit janë sisteme shpërndarës me tubacione polietileni nën presion deri 4 bare (duke përfshirë 4 bare) të cilët shërbejnë për transportin e gazit nga stacionet e matjes dhe rregullimit deri te shfrytëzuesit e fundit të gazit.

<sup>21</sup> Gazeta Zyrtare nr.152/2010

<sup>22</sup> Neni 1, Dispozita të përgjithshme të rregullores

<sup>23</sup> Fletore Zyrtare e RSFJ numër 10/1990



energjetikë dhe paraqet institucion i cili e mbron dhe avancoon sektorin energjetik dhe i mbron interesat e konsumatorëve. Formimi i KRRE është një reformë e rëndësishme në sektorin energjetik të Republikës së Maqedonisë, ndërsa me këtë plotësisht u përmbushën kërkesat e Direktivës së BE nr. 53/2003 për rregulla të përbashkëta në tregun e brendshëm të energjisë elektrike. Përgjegjësitë dhe detyrimet e KRRE janë përcaktuar në kapitullin 3 të Ligjit për energjetikë. Në nenin 22 janë zhvendosur kompetencat me qëllim që të sigurohet funksionim efikas, konkurrent dhe papengesa të tregjeve energjetike.

#### • Rregullat e tregut të gazit natyror

KRRE, në muajin janar të viti 2014, miratoi Rregulla të tregut të gazit natyror konform nenit 27 dhe nenit 90 nga Ligji për energjetikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 16/11, 136/11, 79/13 dhe 164/13). Me këto Rregulla, KRRE e rregullon organizimin e tregut të gazit natyror, kushtet që duhet t'i përmbushin pjesëmarrësit në tregun e gazit natyror, mënyrën dhe kushtet e bashkimit të blerësve dhe/ose shitësve të gazit natyror në grupe të balancuara për shkak të reduktimit të shpenzimeve të balancimit, vendosjes, organizimit dhe kontrollit të tregtimit me gaz natyror dhe shërbime sistemore, duke e përfshirë edhe tregtinë ndërkufitare, ndarjen e kapaciteteve transmetuese në dispozicion, metodologjinë e përlogaritjes së kompensimit të shërbimeve për balancim, mënyrën e arkëtimit të shërbimeve, si dhe sigurimin financiar të detyrimeve të pjesëmarrësve në tregun e gazit natyror për pagesën e shërbimeve për balancim, procedurën e përlogaritjes së debalanceve midis transaksioneve të nominuara dhe të realizuara, në bazë të të dhënave nga matjet e bëra nga ana e operatorit të sistemit të transmetimit të gazit natyror dhe operatorëve të sistemeve shpërndarëse, kushtet, mënyrën dhe procedurën e furnizimit të gazit natyror dhe shërbimeve ndihmëse nga ana e ushtruesve të veprimtarive të rregulluara energjetike, me qëllim që të sigurohet që furnizimet të zbatohen në mënyrë transparente dhe pa diskriminime dhe të sigurohet qasje e barabartë e të gjithë ofertuesve të interesuar vendor dhe të huaj, si dhe procedura dhe mënyra e grumbullimit dhe paraqitjes së të dhënave deri te Komisioni Rregullator për Energjetikë i Republikës së Maqedonisë

lidhur me gjendjet dhe dukuritë në tregun e gazit natyror<sup>24</sup>.

Neni 4 i Rregullave të tregut të gazit natyror e përkufizon tregun e gazit natyror si një sistem të organizuar për blerjen dhe shitjen e gazit natyror sipas ofertës dhe kërkesës të gazit natyror dhe tregtisë me kapacitete.

#### • Rregullat e furnizimit me gaz natyror

Në bazë të nenit 28 nga Ligji për energjetikë, KRRE, në maj të viti 2012, miratoi Rregulla për furnizimin me gaz natyror. Me këto rregulla rregullohen detyrimet e ndërsjella dhe përgjegjësitë e: furnizuesit, konsumatorit të gazit natyror dhe operatorit të sistemit. Përveç përgjegjësiave, me Rregullat rregullohen edhe kushtet e livrimit cilësor të gazit natyror, cilësia e shërbimeve, sigurimi i informacioneve të nevojshme dhe komunikimi përkatës midis të tria palëve të involvuara në sektorin.

#### • Rregullore për çmimet e gazit natyror të furnizuesit në rast të fundit

Në bazë të nenit 22, pika 3) dhe nenit 24, paragrafi (2) nga Ligji për energjetikë<sup>25</sup>, Komisioni Rregullator për Energjetikë i Republikës së Maqedonisë, në mbledhjen mbajtur më 11 janar 2013 miratoi Rregullore për çmimet e gazit natyror për furnizues në rast të fundit. Në këtë Rregullore rregullohet mënyra dhe kushtet e përlogaritjes, miratimit dhe kontrollit të çmimeve përfundimtare të gazit natyror për konsumatorët që furnizohen përmes furnizuesit në rast të fundit me gaz natyror.

Dispozitat e kësaj Rregullore vlejnjë për personat juridikë të licencuar nga KRRE dhe ushtrojnë veprimtari, furnizim në rast të fundit<sup>26</sup> me gaz natyror dhe konsumatorët me gaz natyror që furnizohen me gaz natyror përmes furnizuesit në rast të fundit.

Paragrafi 2, neni 4 nga Rregullorja e rregullon çmimin furnizues të gazit natyror si vijon:

*Çmimin furnizues të gazit natyror e përcakton Komisioni Rregullator për Energjetikë për çdo muaj kalendarik të periudhës së rregulluar, në bazë të propozimit të*

<sup>24</sup> Neni 1, Rregullat e tregut të gazit natyror ("Gazeta Zyrtare e RM nr. 16/2014)

<sup>25</sup> "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.16/11 dhe 136/11

<sup>26</sup> Furnizuesi në rast të fundit me gaz natyror është furnizues me gaz natyror i cili e siguron shërbimin publik furnizim me gaz natyror të konsumatorëve të lidhur në sistemin e gazit natyror.



*paraqitur nga furnizuesi në rast të fundit, i hartuar në përputhje me Rregullat e furnizimit të gazit natyror.*

Paragrafi 3, neni 5 nga Rregullorja e rregullon procedurën e aplikimit për miratimin e çmimit furnizues të gazit natyror për çdo muaj kalendarik të periudhës së rregulluar.

#### • Sistemi tarifor i transmetimit të gazit natyror

Komisioni Rregullator për Energjetikë, në janar të vitit 2013, miratoi Sistem tarifor për transmetimin e gazit natyror<sup>27</sup>. Me Sistemin tarifor për transmetimin e gazit natyror rregullohet mënyra e përlogaritjes së kompensimeve të cilat konsumatorët duhet t'i paguajnë për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit të gazit natyror dhe rrjetet e transmetimit të gazit natyror, mënyrën dhe kushtet e përlogaritjes dhe përcaktimit të tarifave për transmetimin e gazit natyror dhe tarifave për avancimin e sistemit të transmetimit të gazit natyror, si dhe përcaktohen kategoritë e konsumatorëve të gazit natyror të lidhur me sistemin e transmetimit të gazit natyror<sup>28</sup>.

Në janar të viti 2013 KRRE mori vendim për **sisteme tarifore për shpërndarjen e gazit natyror dhe për shitjen e gazit natyror për furnizuesin në rast të fundit**<sup>29</sup>. Sistemi tarifor i shpërndarjes së gazit natyror e rregullon mënyrën e përlogaritjes së kompensimeve të cilat konsumatorët duhet t'i paguajnë për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes së gazit natyror, mënyrën dhe kushtet e përlogaritjes së tarifës për shpërndarjen e gazit natyror, si dhe përcaktohen kategoritë e konsumatorëve të gazit natyror të lidhur në sistemin e shpërndarjes së gazit natyror. Me tarifën e shitjes së gazit natyror të furnizuesit në rast të fundit përcaktohet mënyra dhe kushtet e përlogaritjes së tarifës për furnizim në rast të fundit me gaz natyror dhe arkëtimi i kompensimeve për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes të gazit natyror, sasisë së shpenzuar të gazit natyror, si dhe përlogaritjen dhe arkëtimin e kompensimit të furnizuesit në rast të fundit<sup>30</sup>.

**Me Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për mënyrën dhe kushtet e rregullimit të çmimeve për transmetimin, shpërndarjen dhe**

**furnizimin me gaz natyror**<sup>31</sup> nga dhjetori i vitit 2013 rregullohet periudha e rregulluar e veprimtarisë së rregulluar furnizim me gaz natyror të konsumatorëve tariforë, të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë në sistemin e transmetimit. Në përputhje me atë që e rregullon kjo Rregullore, mund të paraqes problem në zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes, nëse edhe më tutje mbetet dispozita-konsumatorë të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë në sistemin e transmetimit, ndërkaq deri në fund nuk është e përcaktuar se ku përfundon sistemi i transmetimit dhe ku fillon shpërndarja. Kjo mund të paraqes pengesë për investitorët, për shembull Qyteti i Shkupit në të cilin tanimë ka mbi 30 lidhje me trajtim të këtillë.

## 2. Kuadri ligjor nacional drejt përmbushjes së akteve normative të BE

Duke i pasur parasysh aspiratat e Republikës së Maqedonisë për anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe rëndësinë e politikave energjetike të të gjitha shteteve dhe banorëve evropian, legjislacioni evropian ka ndikim të madh mbi legjislacionin nacional dhe veçanërisht në fushën e energjetikës. Megjithatë, politika energjetike e Republikës së Maqedonisë krijohet dhe zhvillohet në përputhje me parimet e Bashkimit Evropian. Nënshkrimi i Marrëveshjes për komunitetin energjetik<sup>32</sup> për Republikën e Maqedonisë dhe për vendet e tjera nënshkruese nga rajoni juglindor i Evropës, nënkupton ndjekje të detyrimeve të cilat burojnë nga marrëveshja, përkatësisht harmonizim të legjislacionit nacional me aktet ekzistuese ligjore dhe nënligjore të Bashkimit Evropian<sup>33</sup> sa i përket sektorit energjetik, mjedisit jetësor, efikasitetit energjetik, burimeve të rinovueshme të energjisë dhe rezervave të naftës, me fokus të veçantë mbi furnizimin e sigurt, stabil dhe papengesa të gazit natyror dhe energjisë elektrike të të gjitha vendeve nënshkruese të Marrëveshjes.

<sup>31</sup> "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.185/13

<sup>32</sup>[http://www.energy-community-](http://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/ENERGY_COMMUNITY/Legal/Treaty)

[ty.org/portal/page/portal/ENC\\_HOME/ENERGY\\_COMMUNITY/Legal/Treaty](http://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/ENERGY_COMMUNITY/Legal/Treaty)

<sup>33</sup> Acquis communautaire (termin francez) i cili ka të bëjë me autoritetin përmbledhës të ligjeve të komunitetit evropian, i përbërë nga objektivat e KE, rregullave dhe politikave thelbësore dhe veçanërisht me aktet ligjore dhe nënligjore dhe me të drejtën zakonore - çdo gjë që është pjesë e rregullimit juridik të Bashkimit Evropian (BE): marrëveshje, rregullore dhe direktiva. Kjo është baza dhe e njëjta është detyrime për të gjitha vendet-anëtare të Unionit.

<sup>27</sup> "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 19/13

<sup>28</sup> f. 53, Raport për punën e Komisionit Rregullator për Energjetikë të Republikës së Maqedonisë në vitin 2013.

<sup>29</sup> "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.19/13

<sup>30</sup> f. 53, Raport për punën e Komisionit Rregullator për Energjetikë të Republikës së Maqedonisë në vitin 2013.





Republika e Maqedonisë e konstruktivoi kuadrin ligjor për energjetikë sipas objektivave dhe kërkesave të Bashkimit Evropian. Ligji për energjetikë i Republikës së Maqedonisë dhe rregulloret me të cilat janë rregulluar çështje të veçanta lidhur me këtë problematikë e përbëjnë kuadrin themelor ligjor si edhe shumë ligje të tjerë dhe politika të cilat ndikojnë mbi zhvillimin e energjetikës. Pasqyra e shkurtër do të ndihmojë në drejtim që të kuptohet përshkrimi i politikave nacionale energjetike, konkretisht procesi i miratimit të vendimeve, krijimit të politikave, miratimit të rregulloreve dhe urdhëresave për rregullimin e tregut me gaz natyror, si objektiva shumë të rëndësishme strategjike për ardhmërinë e vendit.

Aktet normative të BE lidhur me gazin natyror të cilat Republika e Maqedonisë duhet t'i ndjek me qëllim të përmbushjes së Marrëveshjes së Komuniteti Energjetik dhe respektimit të *acquis* - it për gaz janë:

**- Direktiva 2009/73/KE nga 13 korrik 2009 për vendosjen e rregullave të përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror. Me këtë Direktivë shfuqizohet Direktiva 2003/55/ KE.**

**- Direktiva 2004/67/ KE ka të bëjë me masat e mbrojtjes së sigurisë së furnizimit me gaz natyror.**

**- Rregullorja nr. 715/2009 e KE nga 13 korrik 2009 për kushtet e qasjes deri te rrjetet e transmetimit të gazit natyror, me këtë shfuqizohet Rregullorja 1775/2005.**

Sa i përket ndjekjes së direktivave evropiane dhe rregulloreve, me qëllim të përmbushjes së *acquis communautaire* dhe objektivave të Pakos së tretë të Bashkimit Evropian, Republika e Maqedonisë shënon progres dhe në përgjithësi e ndjek tendencën e harmonizimit dhe zbatimit të të njëjtave. Në sektorin e gazit mund biem dakord se ndihet një "lëvizje", veçanërisht në kuadrin e akteve nënligjore të tregut të gazit natyror. Zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes së gazit është në rrjedhë e sipër, ashtu siç u theksua më lartë, në rrjedhë e sipër është përzgjedhja e koncesionerit për marrëveshje të PPP për gazifikim.

Kohëve të fundit ndodhën më shumë ndryshime lidhur me aktet nënligjore për rregullimin e tregut të gazit natyror, ndërkaq pasojnë edhe në periudhën e ardhshme.

Në periudhën e ardhshme, gjatë vitit 2014, pritet që KRRE të miratojë akte nënligjore të nevojshme për vendosjen e tregjeve funksionale të energjisë konform Ligjit për energjetikë dhe legjislacionit të BE-së, përkatësisht të implementohen dispozitat e direktivave

2009/72/KE, 2009/73/KE, 2004/67/EC, si dhe Rregullorja 715/2009. Tanimë është në rrugë të mbarë që në janar të vitit 2014 t'i miratojë Rregullat e tregut të gazit natyror, me të cilat përcaktohet organizimi i tregut të gazit natyror, si dhe kushtet që duhet t'i përmbushin pjesëmarrësit e tregut të gazit natyror, e që është në përputhje me masat e direktivave të BE-së për rregulla të përbashkëta të tregut të brendshëm dhe detyrimet nga Marrëveshja për themelimin e Komunitetit Energjetik. Në përputhje me nenin 94 nga Ligji për energjetikë, operatorët e sistemeve të shpërndarjes së gazit natyror i paraqitën për miratim pranë KRRE Rregullat e rrjetit për shpërndarjen e gazit natyror dhe janë në procedurë të shqyrtimit me imperativ që të miratohen deri në fund të muajit qershor të vitit 2014. Me këtë do të përmbushen edhe dispozitat e Direktivës 2009/73/KE. Deri në fund të vitit pritet të përmbushet detyrimi për miratimin e Rregullave të rrjetit për transmetimin e gazit natyror me qëllim të përmbushjes së dispozitave të Direktivës 2009/72/KE. Për përmbushjen e këtij detyrimi, operatori i sistemit të transmetimit të gazit natyror duhet t'i paraqes Rregullat e rrjetit për transmetimin e gazit natyror për miratim në KRRE, konform nenit 88 nga ligji për energjetikë. Në vitin 2013 u miratua Vendimi për sisteme tarifore për shpërndarjen e gazit natyror dhe për shitjen e gazit natyror të furnizuesit në rast të fundit.

Sipas detyrimit nga Marrëveshja e Komunitetit Energjetik, deri në fund të vitit 2014 duhet të miratohet Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për energjetikë në të cilin do të transponohen detyrimet të cilat burojnë nga Pakoja e tretë të tregut të brendshëm të energjisë të Bashkimit Evropian edhe atë harmonizim me Direktivat 2009/73/KE, 2009/72/KE dhe rregulloret 714/2009 dhe 715/2009. Ndryshimet do të bëhen me qëllim të krijimit të kushteve konkurrenente për tregjet e energjisë elektrike dhe gazit natyror përmes pavarësisht të operatorëve të sistemeve të transmetimit, përforcimin e pozicionit të Komisionit Rregullator për Energjetikë të Republikës së Maqedonisë mbrojtja e konsumatorëve etj.<sup>34</sup>.

Me qëllim të rregullimit të tregut të brendshëm të gazit natyror, në periudhën e ardhshme, pritet të ndërmerren hapa konkret në drejtim të liberalizimit të këtij tregu, përkatësisht t'u sigurohet mundësi të gjithë konsumatorëve që ta zgjedhin furnizuesin e tyre të

---

<sup>34</sup> Programi nacional për miratimin e të drejtës së Bashkimit Evropian, Revizioni 2014 – 2016



energjisë. Përkatësisht, deri në janar të vitit 2015, Republika e Maqedonisë duhet t'i përmbush detyrimet të cilat rezultojnë nga miratimi i Pakos së tretë të energjisë të BE (Direktiva 2009/72 dhe 2009/73 dhe Rregulloret 714/2009 dhe 715/2009 dhe amendamentet e neneve 11 dhe 59 nga Marrëveshja për Komunitetin Energjetik)<sup>35</sup>. Me këtë harmonizim pritet të rritet konkurrenca e tregut të energjisë, të ketë pavarësi më të madhe të operatorëve të sistemeve të transmetimit dhe inkomporimit të masave për konsumatorët vulnerabil dhe mbështetjen e tyre<sup>36</sup>.

---

<sup>35</sup> Vendim i Këshillit të Ministrave të Komunitetit Energjetik nga 6 tetor 2011

[www.energy-community.org/pls/portal/docs/1146182.PDF](http://www.energy-community.org/pls/portal/docs/1146182.PDF)

<sup>36</sup> Programi nacional për miratimin e të drejtës së Bashkimit Evropian, Revizioni 2014 – 2016



## KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Gazi natyror është i domosdoshëm për Republikën e Maqedonisë. Zhvillimi i ekonomisë dhe stabiliteti social i qytetarëve, gjatë tendencës së vazhdueshme të rritjes së çmimeve të burimeve energjetike, do të varet nga mundësia për qasje në rrjetin e furnizimit me gaz natyror. Për këtë shkak Qeveria e Maqedonisë i ndërmerr hapat paraprak të drejtpërdrejtë për realizimin e këtij programi.

Janë hartuar studimet e nevojshme, pjesërisht edhe projektet kryesore. Së shpejti, pritet të nënshkruhet Marrëveshja për realizimin e borxhit rus në shumë prej 60 M\$ ndërsa Qeveria parashikon të investojë edhe 300 M€ për ndërtimin e infrastrukturës së gazit.

Aktet ligjore dhe nënligjore janë harmonizuar me legjislacionin e BE.

Për realizimi e tërë programit të gazifikimit nevojiten investime të konsiderueshme. Për këtë shkak, Qeveria është e gatshme të pranojë PPP me investitorë të huaj ose të jap në koncesion ndërtimin e seksioneve transportuese ose rrjeteve shpërndarëse, në kushte të ndershme të tregut. Përveç kontributit financiar pritet kontributi i tyre edhe në transferimin e teknologjive të reja, sigurinë e rritur gjatë kontrollit të sistemeve, formimin e laboratorëve të nevojshëm dhe trajnimin e personelit. Tanimë është shpallur thirrja publike për paraqitjen e interesit për ndërtimin e rrjetit shpërndarës në kryeqytetin e Republikës së Maqedonisë, Shkup.

Kapaciteti ekzistues i gazsjellësit magjstral siguron livrim të mjaftueshëm të gazit për nevojat në 5 vitet e ardhshëm. Në këtë periudhë kohore duhet të ndërtohet rrjeti shpërndarës në Shkup (konsumues i konsiderueshëm i gazit natyror), si dhe gazsjellësit magjstral deri në Negotinë/Kavadar dhe eventualisht seksioni në drejtim të Tetovës/Gostivarit.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë nënshkroi Marrëveshje strategjike me GASPROM për sigurimin e sasive të mjaftueshme të gazit natyror për periudhën e ardhshme kohore deri në vitin 2013, madje edhe më shumë. Me këtë Marrëveshje është siguruar siguria për blerjen e gazit nga një prodhues i madh. Hyrja e lidhjes me gazsjellësin magjstral Rrjedha Jugore në Republikën e Maqedonisë nuk është e një rëndësie esenciale.

Mosmarrëveshjet aktuale midis BE dhe investuesit të ndërtimit të Rrjedhës Jugore, janë të karakterit kalimtar. Interesat ekonomikë janë mjaft të fuqishëm për të dyja palët, kështu që për një kohë të shkurtër mosmarrëveshjet do të tejkalohen. Nuk ekziston rreziku nga pengimi i ndërtimit të gazsjellësit Rrjedha Jugore.

Në përputhje me çmimet aktuale të burimeve energjetike mund të pritet që për një periudhë shumë të shkurtër kohore të kemi ekspansion të furnizimit me gaz natyror të objekteve të cilat nuk janë në trajektoren e gazsjellësit, përkatësisht shpërndarje virtuale të gazit natyror. Kjo është e mirëseardhur për konsumatorët si nga aspekti financiar ashtu edhe nga ai ekologjik. Pajisja e rikostruktuar do të përdoret edhe kur do të ketë mundësi për lidhje në gazsjellës.

Do të ishte mirë të realizohet lidhje me Shqipërinë nëse manifestohet interesim nga ana e tyre. Lidhja e këtillë është mjaft e dobishme, veçanërisht për të ardhmen, pasi që do të ndërtohet gazsjellësi TAP apo terminali për gaz të lëngshëm në njërin prej porteve të Shqipërisë.

Duhet të manifestohet interesim për lidhje me gazsjellësin magjstral TAP. Zgjidhje optimale për Republikën e Maqedonisë është mundësia e furnizimit me gaz natyror nga dy drejtime dhe nga dy furnizues me gaz.



## BIBLIOGRAFIA

- BP Statistical Review of World Energy June 2013
- Development Of The Application/Use Of Natural Gas, K. Dimitrov, J. D. Kapac, O. Dimitrov, Geopolitics of Natural Gas and Supply Security , 5 International Symposium on Natural Gas, INGAS 2013, Istanbul
- [http://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC\\_HOME/ENERGY\\_COMMUNITY/Legal/Treaty](http://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/ENERGY_COMMUNITY/Legal/Treaty)
- <http://www.south-stream.info/en/pipeline/route/>
- <http://www.trans-adriatic-pipeline.com/tap-project/>
- Skopje' Natural Gas Network – A Measure To Implement Energy Efficiency Strategy, Prof. d-r Konstantin Dimitrov, Jasminka Kapac, BSc, Ass. M-r Ognen Dimitrov, INGAS International Symposium on Natural Gas - The Balkans 2010, Skopje/ Macedonia
- Sistemi tarifor për transmetimin e gazit natyror "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 19/13
- Analizë e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për energjetikë nga muaji maj 2013, f. 5, Analitika
- Analizë e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për energjetikë nga muaji maj 2013, f. 8, Analitika
- Ligji për energjetikë, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 79/ 2013
- Ligji për energjetikë, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 16/11 dhe 136/11
- Programi nacional për miratimin e të drejtës së Bashkimit Evropian, Revizioni 2014 – 2016
- Vendim i Këshillit të Ministrave të Komunitetit Energjetik nga 6 tetori 2011., [www.energy-community.org/pls/portal/docs/1146182.PDF](http://www.energy-community.org/pls/portal/docs/1146182.PDF)
- Rregullat e tregut të gazit natyror, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 16/2014)
- Rregullore për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e sigurt të sistemeve të gazsjellësve me tubacione polietileni nën presion deri në 4 bare, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.100/2009
- Rregullore për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e sigurt të objekteve, aparateve dhe instalimeve për instalime të brendshme të gazit, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.152/2010
- Rregullore për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e sigurt të objekteve, aparateve dhe instalimeve për instalime të brendshme të gazit
- Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për mënyrën dhe kushtet e rregullimit të çmimeve për transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin me gaz natyror, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.185/13
- Fletore Zyrtare e RSFJ numër 10/1990



- f. 53, Raport për punën e Komisionit Rregullator për Energjetikë të Republikës së Maqedonisë në vitin 2013.
- Strategjia për Shfrytëzimin e Burimeve të Rinovueshme të Energjisë në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2020, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 125/2010
- Strategjia për Zhvillimin e Energjetikës në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2030, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 61/2010
- Strategjia për Avancimin e Efikasitetit Energjetik deri në vitin 2020, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 143/2010
- Studimi i Fizibilitetit për sistemin gazsjellës në Republikën e Maqedonisë, i përgatitur nga Konzorciumi: "Prostor" SHPK – Kumanovë, "Energo Sistem" SHPK Shkup, GASTEC Sofje, "Petrol" Lubjanë dhe EIHP Zagreb nga muaji qershor 2010
- Studimi i Fizibilitetit për zhvillimin e rrjeteve shpërndarëse të gazit natyror në Republikën e Maqedonisë, 2013/2014



## PËR AUTORËT

**Prof. Dr. Konstantin Dimitrov** ka mbi 40 vjet përvojë profesionale në fushën e energjisë komplekse, efikasitetit energjetik, mbrojtjen e mjedisit jetësor, prodhimit të kombinuar, zbatimit të BRE dhe matjeve diagnostike. Është autor i mbi 450 publikimeve dhe materialeve shkencore dhe profesioniste brenda dhe jashtë vendit. Ka ligjësuar në universitetet në Shkup, Manastir (Republika e Maqedonisë) dhe Prishtinë (Kosovë).

**Zoja Tarevska** është politikologe e diplomuar dhe aktualisht është në studime pasuniversitare për menaxhmentin politik në Fakultetin Juridik në Shkup. Gjatë studimeve, ajo ka bashkëpunuar me më shumë organizata rinore dhe ka marrë pjesë në disa OJQ. Ka marrë pjesë në një sërë seminaresh brenda dhe jashtë vendit. Ajo është e angazhuar në disa projekte evropiane në fushën e energjetikës. Zoja është një hulumtuuese e re në fushën e politikës energjetike. Aktualisht është e punësuar në MACEF – Qendra për Efikasitet Energjetik.

**Pikëpamjet e prezantuara në këtë punim janë qëndrime personale të autorëve dhe nuk i pasqyrojnë pikëpamjet e Fondacionit Konrad Adenauer.**

### Kontakti:



Konrad  
Adenauer  
Stiftung



#### **Fondacioni Konrad Adenauer**

“Maksim Gorki” 16 / kati 3  
MK – 1000 Shkup  
Telefoni +389 (2) 3231 122  
Telefaksi +389 (2) 3135 290  
[Skopje@kas.de](mailto:Skopje@kas.de)  
[www.kas.de/macedonia](http://www.kas.de/macedonia)

#### **Qendra për Efikasitetin Energjetik të Maqedonisë**

**Shoqata MACEF Shkup**  
Rr. “Nikolla Parapunov” 3a/51-2,  
QT Karposh 4,  
MK – 1000 Shkup  
Tel/faks: +389 (2) 3090 178  
+389 (2) 3090 179  
[macef@macef.org.mk](mailto:macef@macef.org.mk)  
[www.macef.org.mk](http://www.macef.org.mk)